



Nr.30/1Prot

Datë 30.05.2026

### ANKIM

**ANKUES: Partia e Lirisë dhe** Lefter Maliqi, i biri i Novrus dhe Esmë, lindur më 10.02.1972 në Berat, banues në Kuçovë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Përfaqësuar nga **Avokatët** Arben Llangozi dhe Orgesa Serani, me Adresë: *Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga "Don Bosko", Kulla nr. 2, Zyra nr.7, kati parë, Tiranë.*

**Objekti:** Ankim ndaj vendimit nr. 35, datë 21.05.2026, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me objekt "Për shqyrtimin administrativ të rezultatit të verifikimit për subjektin vetëdeklarues, z. Kreshnik Riza Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë".

**Baza Ligjore:** Kodit Zgjedhor, neni 4,13,14,23,24,90,109,116 i Kodi i Proçedurave Administrative. Neni 92 i K.Pr.Civile. Ligj nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; si dhe parimet e procesit të rregullt ligjor, ligjshmërisë, sigurisë juridike, administrimit të mirë dhe efektivitetit të ankimit administrativ.

**Drejtuar:** Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve Tiranë

### Të nderuar:

Në datën 21.05.2026, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë vendimin nr. 35, me të cilin ka pranuar kërkesën e palës së interesuar z. Lefter Maliqi për përjashtimin/heqjen dorë të Komisionerit nga shqyrtimi administrativ i çështjes që lidhet me verifikimin e kushteve të ndalimit për ushtrimin e funksionit publik nga z. Kreshnik Riza Hajdari.

Në këtë vendim, vetë Komisioneri ka pranuar se më parë është shprehur për të njëjtën çështje, mbi të njëjtat fakte dhe mbi të njëjtin objekt, me vendimin nr. 816, datë 14.11.2023, vendim i cili më

pas është shfuqizuar nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve me vendimin nr. 1, datë 05.01.2024, duke e kthyer çështjen për rishqyrtim.

Gjithashtu, nga përmbajtja e vendimit rezulton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3947 (3953), datë 06.11.2025, ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor dhe e ka dërguar për vazhdimin e shqyrtimit pranë KQZ-së, ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 349, datë 02.04.2026, ka lënë në fuqi këtë vendim.

Pra, organet gjyqësore e kanë orientuar qartë zgjidhjen e çështjes pranë KQZ-së, duke e kthyer atë në rrugën administrative kompetente. Në këto kushte, vendimi i Komisionerit për të mos e shqyrtuar çështjen në themel dhe për të hequr dorë nga shqyrtimi administrativ nuk i jep zgjidhje problemit, por e lë atë pezull, në kundërshtim me vendimet gjyqësore dhe me qëllimin e ligjit nr. 138/2015.

Pasi jemi njohur me Vendimin Nr. 35, datë 21.5.2026 Për Shqyrtimin Administrativ të Rezultatit të verifikimit për subjektin vetëdeklarues Kreshnik Hajdari, kryetari I Bashkisë Kuçovë, I propozuar nga Subjekti Zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", ushtrojmë ankimin me përmbajtje si më poshtë.

Së pari, parashtrojmë se afati i ankimit nuk është 30 ditë, ashtu sikurse është shënuar në vendim por 5 ditë, pasi vendimi nr. 35, datë 21.05.2026, ka natyrë procedurale, të ndërmjetme dhe nuk përbën vendimmarrje përfundimtare mbi themelin e çështjes

Në pikën 4 të dispozitivit të vendimit nr. 35, datë 21.05.2026, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka përcaktuar se kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga shpallja e tij.

Ky përcaktim është i gabuar, i pabazuar në natyrën juridike të aktit dhe cenon rëndë të drejtën e ankimit efektiv, pasi vendimi objekt ankimi nuk është një vendim përfundimtar mbi themelin e çështjes së dekriminalizimit, por është një vendim procedural, i ndërmjetëm, që lidhet vetëm me mënyrën e vijimit të procedurës administrative dhe me çështjen e pjesëmarrjes ose jo të Komisionerit në shqyrtim.

Vendimi nr. 35, datë 21.05.2026, nuk ka vendosur nëse z. Kreshnik Riza Hajdari ndodhet ose jo në kushtet e ndalimit të parashikuara nga ligji nr. 138/2015. Ai nuk ka dhënë zgjidhje mbi mandatin, nuk ka analizuar në themel rezultatin e verifikimit, nuk ka vlerësuar pasojat juridike të procedimit penal dhe të vendimit penal ndaj subjektit vetëdeklarues, nuk ka marrë qëndrim mbi pavlefshmërinë ose vlefshmërinë e ushtrimit të funksionit publik dhe nuk ka përmbushur detyrimin për rishqyrtim të çështjes, të lënë nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve dhe nga vendimet gjyqësore.

Përkundrazi, ky vendim është kufizuar vetëm në trajtimin e një çështjeje paraprake procedurale, konkretisht nëse Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhej ose jo të vazhdonte shqyrtimin administrativ të çështjes. Pra, vendimi nuk e zgjidh konfliktin administrativ në themel, por trajton vetëm një incident procedural të lindur gjatë procedurës administrative.

Në të drejtën administrative, dallimi ndërmjet vendimit përfundimtar dhe vendimit të ndërmjetëm është thelbësor për përcaktimin e regjimit të ankimit. Vendimi përfundimtar është ai që shprehet mbi të drejtat, detyrimet apo interesat substanciale të palëve dhe e mbyll procedurën në themel. Ndërsa vendimi i ndërmjetëm është ai që merret gjatë zhvillimit të procedurës, lidhet me organizimin, drejtimin, vijimin apo rregullsinë e saj dhe nuk shprehet mbi objektin final të shqyrtimit.

Në rastin konkret, vendimi nr. 35 nuk e mbyll çështjen e dekriminalizimit në kuptimin material, nuk jep zgjidhje mbi kushtet e ndalimit, nuk shprehet mbi statusin juridik të z. Kreshnik Hajdari në raport me ligjin nr. 138/2015 dhe nuk vendos përfundimisht mbi pasojat e verifikimit. Për këtë arsye, ai nuk mund të trajtohet si vendim përfundimtar me afat ankimi 30-ditor, por duhet të trajtohet si vendim procedural/të ndërmjetëm, ndaj të cilit ankimi duhet të shqyrtohet në afatin e shkurtër 5-ditor.

Përcaktimi i afatit 30-ditor në dispozitiv është në kundërshtim me natyrën urgjente të çështjeve zgjedhore dhe të procedurave që lidhen me ushtrimin e funksioneve publike. Çështjet e dekriminalizimit nuk janë çështje administrative të zakonshme, por janë çështje me rëndësi të lartë publike, që lidhen drejtpërdrejt me integritetin e funksionarëve publikë, me besimin e qytetarëve te institucionet, me ligjshmërinë e ushtrimit të mandatit dhe me zbatimin e parimit të shtetit të së drejtës.

Në një procedurë të tillë, çdo vonesë e pajustificuar prodhon pasoja konkrete. Nëse ankimi ndaj një vendimi të ndërmjetëm trajtohet me afat 30-ditor, atëherë shqyrtimi në themel shtyhet artificialisht, procedura administrative mbetet pezull dhe personi për të cilin kërkohet verifikimi vazhdon të ushtrojë funksion publik pa një vendimmarrje përfundimtare mbi kushtet e ndalimit.

Për rrjedhojë, afati 30-ditor nuk është thjesht një pasaktësi teknike ose formale. Ai ka pasoja të drejtpërdrejta juridike dhe praktike, sepse krijon efektin e zvarritjes së procedurës dhe bllokimit të shqyrtimit në themel. Një afat i tillë, kur vendoset për një vendim të ndërmjetëm procedural, e shndërron mjetin e ankimit nga instrument kontrolli ligjor në instrument vonese.

Në rastin konkret, kjo është edhe më e rëndë, pasi procedura administrative dhe gjyqësore lidhur me z. Kreshnik Hajdari ka nisur që prej vitit 2023 dhe ende nuk ka marrë një zgjidhje përfundimtare në themel. Çështja është kthyer për rishqyrtim nga KAS, është trajtuar nga Gjykata Administrative dhe më pas nga Gjykata e Lartë, e cila ka konfirmuar se shqyrtimi duhet të vijojë pranë KQZ-së. Në këto kushte, çdo afat shtesë, i panevojshëm dhe i papërshtatshëm, rëndon edhe më shumë cenimin e afatit të arsyeshëm dhe të parimit të administrimit të mirë.

Vendosja e afatit 30-ditor për një vendim të ndërmjetëm krijon dyshimin e arsyeshëm se ky afat është përdorur si mjet për të shmangur shqyrtimin e menjëhershëm të çështjes dhe për të shtyrë në kohë zgjidhjen përfundimtare. Ky dyshim bëhet edhe më i arsyeshëm për faktin se vendimi nr. 35 nuk përcakton asnjë mekanizëm konkret për vijimin e procedurës, nuk cakton strukturën që do ta marrë në shqyrtim, nuk përcakton afate për vazhdimin e hetimit administrativ dhe nuk jep asnjë orientim mbi mënyrën se si do të zbatohet detyrimi i KQZ-së për të vendosur në themel.

Pra, nga njëra anë Komisioneri deklaron heqjen dorë nga shqyrtimi administrativ, ndërsa nga ana tjetër vendos një afat 30-ditor ankimi, duke e lënë praktikisht çështjen në një gjendje pezullimi dhe pasigurie institucionale. Kjo gjendje nuk përputhet me parimin e efektivitetit të procedurës administrative, me detyrimin e organit publik për të vendosur brenda afatit të arsyeshëm dhe me qëllimin e ligjit nr. 138/2015.

Ligji i dekriminalizimit ka për qëllim të garantojë që personat që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike të plotësojnë kushtet e integritetit ligjor. Ky ligj nuk mund të zbatohet në mënyrë formale, të ngadaltë ose të zvarritur, sepse zvarritja vetë mund të sjellë konsumimin e paligjshëm të mandatit dhe cenimin e interesit publik. Për këtë arsye, çdo interpretim procedural duhet të jetë në funksion të zgjidhjes së shpejtë dhe efektive të çështjes, jo në funksion të shtyrjes së saj.

Në këtë kuptim, afati 5-ditor është i vetmi afat që i përgjigjet natyrës së vendimit objekt ankimi. Ky afat përputhet me karakterin e vendimit si vendim procedural/të ndërmjetëm, me natyrën urgjente të çështjeve zgjedhore dhe me nevojën që KAS të ndërhyjë menjëherë për të shmangur bllokimin e mëtejshëm të procedurës.

Në të kundërt, pranimi i afatit 30-ditor do të legalizonte një vonesë të pajustificuar dhe do të krijonte një precedent të rrezikshëm, sipas të cilit çdo vendim procedural i KQZ-së, edhe kur nuk zgjidh themelin, mund të përdoret për të shtyrë për një kohë të gjatë shqyrtimin e çështjeve që lidhen me integritetin e funksionarëve publikë. Një qasje e tillë bie ndesh me funksionin kontrollues të KAS, me frymën e Kodit Zgjedhor dhe me qëllimin publik të ligjit nr. 138/2015.

Gjithashtu, duhet theksuar se përcaktimi i gabuar i afatit të ankimit nga organi që ka nxjerrë aktin nuk mund të cenojë të drejtën e palës për ankim efektiv dhe as nuk mund të përcaktojë artificialisht natyrën juridike të vendimit. Natyra e aktit nuk përcaktohet nga mënyra se si e emërton ose e trajton organi administrativ, por nga përmbajtja reale e tij, nga objekti që zgjidh dhe nga pasojat juridike që prodhon.

Në rastin konkret, përmbajtja reale e vendimit tregon qartë se ai nuk zgjidh çështjen në themel, por trajton vetëm vijimin ose mosvijimin e procedurës nga Komisioneri. Për këtë arsye, pavarësisht se në dispozitiv është shënuar afati 30-ditor, KAS duhet të vlerësojë natyrën reale të vendimit dhe të konstatojë se ankimi është i pranueshëm sipas afatit të shkurtër 5-ditor.

Përdorimi i afatit 30-ditor në këtë rast dëmton edhe parimin e sigurisë juridike. Palët kanë të drejtë të dinë se procedura do të zhvillohet me ritëm të arsyeshëm dhe se aktet e ndërmjetme nuk do të përdoren për ta penguar shqyrtimin në themel. Kur një organ publik vendos një afat të gjatë për ankimin ndaj një vendimi që nuk e zgjidh çështjen, ai krijon pasiguri mbi fatin e procedurës dhe cenon besimin e palëve të administrata zgjedhore.

Për më tepër, afati 30-ditor nuk mund të përdoret si mburojë për të justifikuar mosveprimin. KQZ-ja dhe organet e saj kanë detyrimin të veprojnë aktivisht, të administrojnë procedurën dhe të japin zgjidhje efektive. Në rastin konkret, çështja nuk mund të presë edhe 30 ditë vetëm për të zgjidhur një incident procedural, ndërkohë që objekti kryesor lidhet me ushtrimin e një funksioni publik dhe me zbatimin e një ligji me rëndësi të veçantë publike.

Në këto kushte, KAS duhet të konstatojë se afati i vendosur në pikën 4 të dispozitivit të vendimit nr. 35, datë 21.05.2026, është i gabuar dhe nuk i përgjigjet natyrës juridike të vendimit. Vendimi objekt ankimi është akt procedural/të ndërmjetëm dhe ankimi ndaj tij duhet të trajtohet sipas afatit të shkurtër 5-ditor.

Për këtë arsye, kërkojmë që KAS të pranojë ankimin si të paraqitur brenda afatit ligjor të zbatueshëm, të mos lejojë që përcaktimi i gabuar i afatit 30-ditor të prodhojë pasoja në dëm të palës ankuese dhe të konstatojë se ky afat nuk mund të përdoret për të shtyrë shqyrtimin e menjëhershëm të çështjes në themel.

Në përfundim, përcaktimi i afatit 30-ditor në vendimin nr. 35, datë 21.05.2026, duhet të konsiderohet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm për efekt të ankimit në rastin konkret, pasi bie ndesh me natyrën procedurale të vendimit, me urgjencën e çështjes, me parimin e afatit të arsyeshëm, me të drejtën për ankim efektiv dhe me qëllimin e ligjit nr. 138/2015 për garantimin e integritetit të personave që ushtrojnë funksione publike.

Komisioneri Z.Ilirjan Celibashi, edhe pse ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit ose të mungesës së paanësisë objektive, kishte detyrimin të garantonte zgjidhjen e çështjes dhe jo ta linte atë pa zgjidhje .

Pala ankuese ka kërkuar përjashtimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, z. Ilirjan Celibashi, nga shqyrtimi i çështjes që lidhet me verifikimin e kushteve të ndalimit për ushtrimin e funksionit publik nga z. Kreshnik Riza Hajdari, për shkak se Komisioneri ishte shprehur më parë mbi të njëjtën çështje, me të njëjtin objekt, mbi të njëjtat fakte dhe në raport me të njëjtin subjekt vetëdeklarues, përmes vendimit nr. 816, datë 14.11.2023.

Kjo kërkesë është pranuar nga vetë Komisioneri në vendimin nr. 35, datë 21.05.2026. Megjithatë, mënyra se si Komisioneri e ka zgjidhur këtë kërkesë është juridikisht e paplotë, proceduralisht e mangët dhe praktikisht e pazbatueshme, pasi ai është mjaftuar vetëm me deklarin e heqjes dorë nga shqyrtimi administrativ, pa përcaktuar mekanizmin ligjor, strukturën kompetente, afatin dhe rrugën konkrete për vijimin e procedurës.

Në thelb, Komisioneri ka pranuar ekzistencën e rrethanave që cenojnë paanësinë objektive ose që krijojnë dyshim të arsyeshëm mbi paanësinë e tij, por nuk ka garantuar zgjidhjen e pasojave procedurale që rrjedhin nga ky konstatim. Një organ administrativ nuk mund të kufizohet vetëm në konstatimin e pengesës procedurale dhe më pas të braktisë procedurën. Detyra e organit publik nuk përfundon me identifikimin e pengesës, por vijon me detyrimin për të siguruar që procedura të mos mbetet pa vendimmarrje.

Ky është thelbi i këtij shkak ankimi, konflikti i interesit nuk mund të kthehet në arsye për moszgjidhjen e çështjes. Përkundrazi, nëse Komisioneri ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit, të papajtueshmërisë procedurale ose të mungesës së paanësisë objektive, ai kishte detyrimin institucional të përcaktonte se si do të vijonte çështja, kujt do t'i kalonte shqyrtimi, në çfarë afati do të kryhej shqyrtimi dhe si do të garantohej vendimmarrja përfundimtare në themel.

Pranimi i konfliktit të interesit nuk e shuan kompetencën e KQZ-së për të shqyrtuar çështjen. Ai vetëm përjashton një person ose një funksionar konkret nga shqyrtimi, por nuk mund të paralizojë institucionin në tërësi. Përndryshe, do të pranohej një situatë juridikisht e papranueshme, ku mjafton që funksionari përgjegjës të jetë në konflikt interesi që e gjithë procedura të mbetet e bllokuar dhe pa zgjidhje.

Në rastin konkret, çështja nuk ishte para Komisionerit si një çështje e re, fakultative ose e lënë në vlerësimin e tij të lirë. Çështja ishte kthyer për rishqyrtim pas vendimit të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe pas vendimmarrjeve gjyqësore, të cilat kanë orientuar vazhdimin e shqyrtimit pranë KQZ-së. Për këtë arsye, KQZ-ja nuk kishte diskrecion për të mos vepruar, për të mos e zgjidhur çështjen ose për ta lënë atë në një gjendje pezullimi procedural.

Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe vendimi i Gjykatës së Lartë e kanë dërguar çështjen për vazhdimin e shqyrtimit pranë KQZ-së. Kjo do të thotë se detyrimi i KQZ-së ishte të vijonte procedurën administrative dhe të jepte vendimmarrje efektive mbi themelin e verifikimit. Ky detyrim nuk mund të shmangej përmes një vendimi të thjeshtë heqjeje dorë, pa përcaktuar se kush do ta vijonte shqyrtimin.

Në vend që të zbatonte këtë detyrim, Komisioneri ka marrë një vendim që nuk e çon çështjen përpara. Ai nuk ka vendosur mbi themelin, nuk ka shqyrtuar nëse z. Kreshnik Riza Hajdari ndodhet në kushtet e ndalimit, nuk ka analizuar pasojat e vendimit penal, nuk ka caktuar organin ose strukturën që do të vijojë shqyrtimin, nuk ka përcaktuar procedurën pasuese dhe nuk ka vendosur asnjë afat konkret për zgjidhjen e çështjes.

Kjo sjell një pasojë të drejtpërdrejtë dhe të rëndë: çështja mbetet pezull, ndërsa subjekti për të cilin kërkohet verifikimi vazhdon të ushtrojë funksion publik pa një vendimmarrje përfundimtare mbi kushtet e ndalimit. Në këtë mënyrë, qëllimi i ligjit nr. 138/2015 dobësohet në praktikë, sepse procedura e verifikimit nuk përfundon me një vendim mbi themelin, por ngec në një incident procedural.

Një vendim i tillë bie në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë, pasi organi publik duhet të veprojë në përputhje me kompetencën e tij dhe nuk mund të shmangë detyrimin ligjor për të vendosur. Ai bie gjithashtu në kundërshtim me parimin e administrimit të mirë, sepse administrimi i mirë nuk nënkupton vetëm respektim formal të procedurës, por edhe dhënie të një zgjidhjeje efektive, të qartë dhe të zbatueshme për çështjen që i është paraqitur organit publik.

Në të drejtën administrative, organi publik nuk mund të refuzojë zgjidhjen e një çështjeje që është në kompetencën e tij, aq më tepër kur shqyrtimi i saj është urdhëruar ose orientuar nga vendime të mëparshme administrative dhe gjyqësore. Nëse organi publik konstaton një pengesë që lidhet me një funksionar të caktuar, ai duhet të aktivizojë mekanizmin procedural për zëvendësimin, delegimin, kalimin ose rishpërndarjen e çështjes te struktura kompetente, në mënyrë që procedura të vijojë pa ndërprerje.

Në rastin konkret, vendimi nr. 35 nuk bën asnjë nga këto veprime. Ai nuk tregon se cili organ do të marrë përsipër shqyrtimin, nuk tregon nëse çështja do t'i kalojë një strukture tjetër brenda KQZ-së, nuk tregon nëse do të vihet në lëvizje KAS, nuk tregon nëse do të caktohet një vendimmarrës

tjetër dhe nuk përcakton asnjë afat për vijimin e shqyrtimit. Kjo e bën vendimin të paplotë, të paqartë dhe të paafitë për të prodhuar zgjidhje efektive.

Heqja dorë nga shqyrtimi administrativ, pa përcaktuar rrugën e mëtejshme të procedurës, nuk është zgjidhje ligjore. Ajo është vetëm konstatim i një pengese, por jo administrim i pasojave të saj. Një vendim administrativ duhet të jetë i tillë që të sjellë qartësi, të prodhojë pasoja të përcaktuara dhe të orientojë vijimin e procedurës. Vendimi nr. 35, në formën që është marrë, prodhon të kundërtën: krijon pasiguri, lë boshllëk institucional dhe shtyn pa afat zgjidhjen e çështjes.

Ky boshllëk është veçanërisht i rëndë sepse çështja lidhet me ligjin e dekriminalizimit. Ligji nr. 138/2015 ka karakter të posaçëm dhe synon të garantojë integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike. Ky ligj nuk mund të zbatohet në mënyrë të pjesshme, formale apo të zvarritur. Ai kërkon që organet kompetente të kryejnë verifikimin dhe të dalin me një vendimmarrje të qartë: subjekti ndodhet ose nuk ndodhet në kushtet e ndalimit.

Nëse procedura mbetet pezull për shkak të konfliktit të interesit të Komisionerit, atëherë konflikti i interesit kthehet nga një garanci për paanësi në një mjet bllokimi të procedurës. Kjo është juridikisht e papranueshme. Qëllimi i rregullave për konfliktin e interesit është të sigurojnë një proces të drejtë dhe të paanshëm, jo të krijojnë mundësi për mosveprim institucional.

Në këtë kuptim, Komisioneri duhej të pranonte kërkesën për përjashtim, por njëkohësisht të përcaktonte mekanizmin ligjor për vijimin e çështjes. Ai duhej të garantonte që çështja të mos mbetej pa shqyrtim, por t'i kalonte menjëherë organit, trupës ose strukturës kompetente brenda sistemit të KQZ-së, me qëllim që të zbatohet vendimi i KAS, vendimi i Gjykatës Administrative dhe vendimi i Gjykatës së Lartë.

Mosveprimi në këtë drejtim ka sjellë cenimin e parimit të efektivitetit. Një procedurë administrative është efektive vetëm kur përfundon me një vendimmarrje reale mbi objektin për të cilin është nisur. Në rastin konkret, objekti i procedurës nuk ishte thjesht vlerësimi i paanësisë së Komisionerit, por verifikimi i kushteve të ndalimit për ushtrimin e funksionit publik nga z. Kreshnik Riza Hajdari. Vendimi nr. 35 e zhvendos vëmendjen nga themeli i çështjes te një çështje procedurale dhe më pas nuk jep asnjë rrugëzgjidhje për kthimin te themeli.

Po ashtu, vendimi cenon parimin e afatit të arsyeshëm. Procedura ka nisur që prej vitit 2023 dhe ka kaluar në disa faza administrative dhe gjyqësore. Në këtë fazë, pas vendimeve të KAS dhe gjykatave, KQZ kishte detyrimin të vepronte me shpejtësi dhe qartësi. Në vend të kësaj, vendimi nr. 35 krijon një vonesë të re dhe të pajustificuar, duke mos përcaktuar asnjë kalendar procedural për zgjidhjen e çështjes.

Vendimi cenon edhe sigurinë juridike, sepse palët nuk dinë se cila është rruga e mëtejshme e procedurës. Nuk dihet se kush do ta shqyrtojë çështjen, kur do ta shqyrtojë, në çfarë forme do të zhvillohet procedura dhe kur do të merret vendimi përfundimtar. Një situatë e tillë nuk është në përputhje me kërkesat e një administrimi të rregullt, transparent dhe të parashikueshëm.

Për më tepër, vendimi nuk garanton as zbatimin real të vendimeve gjyqësore. Kur Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë e kanë dërguar çështjen për vazhdimin e shqyrtimit pranë

KQZ-së, ky detyrim nuk mund të konsiderohet i përmbushur vetëm sepse Komisioneri zhvillon një seancë dhe më pas deklaron se heq dorë nga shqyrtimi. Zbatimi i vendimit gjyqësor kërkon që çështja të shqyrtohet efektivisht dhe të marrë zgjidhje në themel.

Nëse KQZ-ja, pas kthimit të çështjes nga gjykatat, nuk arrin të japë vendimmarrje për shkak të një konflikti interesi të Komisionerit, atëherë gjendemi përpara një moszbatimi praktik të vendimeve gjyqësore. Kjo cenon parimin e shtetit të së drejtës, pasi vendimet gjyqësore nuk mund të mbeten pa efekt për shkak të pengesave të brendshme organizative të një institucioni administrativ.

Në këtë rast, pengesa nuk është juridikisht e pakapërcyeshme. Konflikti i interesit i një funksionari nuk është arsye për ndërprerjen e procedurës, por arsye për zëvendësimin ose përjashtimin e tij nga vendimmarrja. Institucioni mbetet i detyruar të veprojë. Kompetenca nuk zhduket. Detyrimi për të vendosur nuk shuhet. Çështja nuk mund të mbetet pa përgjigje.

Në këtë drejtim, KAS duhet të vlerësojë se vendimi nr. 35 është i mangët jo sepse ka pranuar ekzistencën e dyshimit mbi paanësinë, por sepse nuk ka dhënë zgjidhje për pasojat e këtij pranimi. Pranimi i kërkesës për përjashtim është vetëm njëra pjesë e vendimmarrjes. Pjesa tjetër, po aq e domosdoshme, ishte përcaktimi i rrugës institucionale për vijimin e shqyrtimit. Mungesa e kësaj pjese e bën vendimin joefektiv dhe të cenueshëm.

Një vendim administrativ nuk mund të jetë i ligjshëm nëse krijon një situatë ku asnjë organ nuk vepron. Administrata publike është e detyruar të japë përgjigje, veçanërisht kur çështja lidhet me interes publik të lartë. Në rastin konkret, interesi publik është i qartë: verifikimi i integritetit të një funksionari publik që ushtron mandatin e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë.

Në këto kushte, vendimi nr. 35 nuk duhet të lihet në fuqi në formën e tij aktuale, sepse ai nuk garanton vazhdimin e procedurës dhe nuk zbaton realisht detyrimet që burojnë nga ligji, nga vendimi i KAS dhe nga vendimet gjyqësore. KAS duhet të ndërhyjë për të shmangur bllokimin institucional dhe për të detyruar vijimin e menjëhershëm të shqyrtimit në themel.

Për sa më sipër, kërkojmë që KAS të konstatojë se Komisioneri, edhe pse mund të ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit ose të mungesës së paanësisë objektive, nuk kishte të drejtë ta linte çështjen pa zgjidhje. Ai kishte detyrimin të siguronte vijimin e procedurës përmes mekanizmit ligjor të përshtatshëm dhe të garantonte që KQZ-ja të përmbushte detyrimin për të vendosur mbi themelin e verifikimit.

Për rrjedhojë, kërkojmë që vendimi nr. 35, datë 21.05.2026, të ndryshohet ose të shfuqizohet në pjesën ku kufizohet vetëm me heqjen dorë nga shqyrtimi administrativ, pa përcaktuar mekanizmin e vijimit të procedurës, dhe të urdhërohet vijimi i menjëhershëm i shqyrtimit administrativ nga organi ose struktura kompetente, me qëllim dhënien e një vendimi përfundimtar mbi kushtet e ndalimit për ushtrimin e funksionit publik nga z. Kreshnik Riza Hajdari.

Në përfundim, konflikti i interesit nuk mund të përdoret si arsye për mosveprim. Ai duhet të përdoret vetëm si garanci për zhvillimin e një procesi të paanshëm nga një organ ose strukturë tjetër kompetente. Çdo interpretim tjetër do ta kthente standardin e paanësisë në mjet për

shmangien e vendimmarrjes, gjë që bie ndesh me ligjshmërinë, administrimin e mirë, afatin e arsyeshëm, sigurinë juridike dhe interesin publik që mbron ligji nr. 138/2015.

Heqja dorë nga shqyrtimi administrativ, pa përcaktuar vijimin e procedurës, krijon boshllëk institucional dhe mohim të së drejtës për vendimmarrje.

Vendimi nr. 35, datë 21.05.2026, është i cenueshëm edhe për faktin se, ndonëse pranon kërkesën për heqjen dorë të Komisionerit nga shqyrtimi administrativ, nuk përcakton asnjë mekanizëm konkret për vijimin e procedurës. Ky është një defekt thelbësor i vendimit, pasi e lë çështjen në një gjendje pasigurie juridike dhe institucionale.

Nëse një funksionar publik i ngarkuar me shqyrtimin e një çështjeje ndodhet në konflikt interesi, në kushtet e papajtueshmërisë procedurale ose në rrethana që krijojnë dyshim të arsyeshëm mbi paanësinë e tij, kjo nuk do të thotë se vetë çështja shuhet, pezullohet pafundësisht apo mbetet pa zgjidhje. Konflikti i interesit lidhet me personin ose funksionarin që nuk duhet të marrë pjesë në vendimmarrje, jo me zhdukjen e detyrimit institucional për të vendosur.

Ligji procedural administrativ ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të palëve përmes një procesi të rregullt, të paanshëm, të shpejtë dhe efektiv. Ky qëllim nuk realizohet nëse organi administrativ thjesht konstaton një pengesë dhe më pas nuk përcakton se si do të vijojë procedura. Një proces i rregullt ligjor nuk është vetëm proces pa konflikt interesi, por edhe proces që përfundon me një vendimmarrje efektive.

Për këtë arsye, në rast konflikti interesi, organi administrativ duhet të aktivizojë mekanizmin zëvendësues, delegates ose institucional që mundëson vijimin e procedurës nga një person, trupë ose strukturë tjetër kompetente. Detyrimi për paanësi nuk mund të kuptohet si e drejtë për të mos vendosur. Përkundrazi, ai duhet të shërbejë si garanci që çështja të vendoset nga një organ i paanshëm, por gjithmonë brenda së njëjtës rrugë institucionale dhe pa e bllokuar procedurën.

Vendimi nr. 35 nuk e bën këtë. Ai nuk tregon kush do ta shqyrtojë çështjen pas heqjes dorë të Komisionerit. Nuk tregon nëse çështja do t'i kalojë një strukturë tjetër brenda KQZ-së. Nuk tregon nëse do të caktohet një funksionar tjetër, një trupë tjetër vendimmarrëse apo një mekanizëm tjetër zëvendësues. Nuk përcakton afatin se kur do të vijojë shqyrtimi. Nuk përcakton procedurën që do të ndiqet pas heqjes dorë. Nuk përcakton si do të zbatohet vendimi i KAS, vendimi i Gjykatës Administrative dhe vendimi i Gjykatës së Lartë.

Kjo mungesë e bën vendimin të paplotë, të paqartë dhe joefektiv. Një vendim administrativ duhet të prodhojë qartësi juridike dhe pasoja të përcaktuara. Ai duhet t'u tregojë palëve se çfarë ndodh më tej, cilat janë të drejtat e tyre, cili organ do të veprojë dhe në çfarë afati do të merret vendimmarrja. Vendimi nr. 35 nuk i përmbush këto kërkesa. Përkundrazi, ai krijon një situatë ku çështja mbetet pa drejtim procedural.

Një vendim administrativ nuk mund të krijojë pasiguri më të madhe se ajo që pretendon të zgjidhë. Në rastin konkret, vendimi synon formalisht të garantojë paanësinë e shqyrtimit, por në praktikë krijon një boshllëk institucional, sepse pas përjashtimit/heqjes dorë të Komisionerit nuk përcaktohet asnjë organ që do të marrë përgjegjësinë për vendimmarrjen. Kështu, në vend që të

garantohet një proces i rregullt, krijohet një situatë ku askush nuk merr përgjegjësinë për të vendosur mbi themelin e çështjes.

Ky boshllëk institucional është juridikisht i papranueshëm. Administrata publike nuk mund të funksionojë mbi bazën e mosveprimit. Organi publik, kur është kompetent për të shqyrtuar një çështje, ka detyrimin të japë zgjidhje. Nëse një funksionar i caktuar nuk mund të marrë pjesë për shkak konflikti interesi, institucioni duhet të veprojë përmes mekanizmave të tjerë të parashikuar ose të lejueshëm nga ligji, me qëllim që kompetenca të ushtrohet dhe procedura të mos paralizohet.

Në të kundërt, do të krijohet një precedent i rrezikshëm, sipas të cilit çdo procedurë administrative mund të bllokohet për shkak të konfliktit të interesit të një funksionari, pa u aktivizuar asnjë mekanizëm zëvendësues. Kjo do ta kthente konfliktin e interesit nga garanci të procesit të rregullt në mjet për shmangien e vendimmarrjes. Një qasje e tillë bie ndesh me qëllimin e rregullave mbi paanësinë, me parimin e ligjshmërisë dhe me funksionin e administratës publike.

Paanësia nuk është qëllim në vetvete i shkëputur nga vendimmarrja. Ajo është një garanci që vendimmarrja të jetë e drejtë, objektive dhe e besueshme. Nëse paanësia përdoret si arsye për të mos vendosur fare, atëherë cenohet vetë qëllimi i procesit të rregullt. Palës i mohohet e drejta për të marrë përgjigje nga organi kompetent dhe çështja mbetet e pazgjidhur.

Në rastin konkret, pala ankuese nuk ka kërkuar që çështja të mbetet pa shqyrtim. Përkundrazi, pala ankuese ka kërkuar që shqyrtimi të zhvillohet nga një organ ose funksionar i paanshëm, në mënyrë që procedura të jetë e rregullt dhe vendimmarrja të jetë e besueshme. Pranimi i kërkesës për përjashtim nuk mund të interpretohet si pranim për bllokimin e procedurës. Kërkesa për përjashtim kishte për qëllim garantimin e paanësisë, jo ndërprerjen e shqyrtimit.

Prandaj, Komisioneri, pasi pranoi kërkesën për heqje dorë, duhej të përcaktonte menjëherë rrugën e vijimit të procedurës. Ai duhej të sqaronte se cili organ ose strukturë do të merrte përsipër shqyrtimin, si do të administroheshin aktet ekzistuese, në çfarë afati do të zhvillohej procedura dhe si do të sigurohej marrja e një vendimi përfundimtar mbi themelin. Mungesa e këtyre elementeve e bën vendimin të pazbatueshëm në praktikë.

Kjo situatë përbën mohim të së drejtës për vendimmarrje. E drejta për një proces të rregullt administrativ nuk kufizohet vetëm te e drejta për të paraqitur kërkesa, prova apo pretendime. Ajo përfshin edhe të drejtën që organi kompetent të marrë një vendim të arsyetuar, të qartë dhe të zbatueshëm. Kur organi administrativ nuk vendos mbi themelin dhe nuk përcakton as se kush do të vendosë, pala mbetet pa mbrojtje efektive.

Në këtë kuptim, vendimi nr. 35 nuk është vetëm i paplotë në aspektin procedural, por cenon vetë aksesin e palës në një vendimmarrje administrative efektive. Pala ankuese ka ndjekur rrugën ligjore, ka paraqitur kërkesa, ka ushtruar ankime dhe ka marrë pjesë në procedura administrative e gjyqësore. Megjithatë, edhe pas kthimit të çështjes pranë KQZ-së, ajo ende nuk ka marrë një përgjigje mbi themelin e pretendimeve të saj. Kjo e bën procesin formal dhe jo efektiv.

Kjo është veçanërisht problematike në një procedurë dekriminalizimi, ku ligji synon reagim të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efektiv ndaj rasteve që lidhen me integritetin e personave që ushtrojnë

funksiione publike. Ligji nr. 138/2015 nuk ka për qëllim të krijojë procedura të pafundme, por të garantojë që personat që mbajnë funksione publike të jenë në përputhje me standardet ligjore të integritetit. Ky qëllim cenohet nëse procedura mbetet pezull për shkak të një vendimi që nuk përcakton vijimin e saj.

Çdo vonesë e pajustificuar në një çështje të tillë sjell pasoja konkrete. Subjekti për të cilin kërkohet verifikimi vijon të ushtrojë funksion publik, ndërkohë që nuk ka një vendimmarrje përfundimtare mbi kushtet e ndalimit. Palët mbeten në pasiguri. Publiku mbetet pa përgjigje mbi ligjshmërinë e ushtrimit të mandatit. Institucioni kompetent nuk e përmbush funksionin e tij kontrollues. Këto pasoja bien ndesh me frymën dhe qëllimin e ligjit të dekriminalizimit.

Në këtë kuadër, vendimi nr. 35 krijon një situatë ku garancia e paanësisë kthehet në pengesë për efektivitetin e procedurës. Kjo nuk mund të pranohet. Paanësia dhe efektiviteti nuk janë parime që përjashtojnë njëri-tjetrin. Përkundrazi, ato duhet të zbatohen bashkërisht: çështja duhet të shqyrtohet nga një organ i paanshëm, por duhet të shqyrtohet dhe të zgjidhet.

Vendimi nr. 35 nuk garanton këtë ekuilibër. Ai pranon problemin e paanësisë, por nuk garanton efektivitetin. Ai shmang pjesëmarrjen e Komisionerit, por nuk garanton vendimmarrje nga një strukturë tjetër. Ai njuh një pengesë procedurale, por nuk jep zgjidhje për kapërcimin e saj. Për këtë arsye, vendimi nuk arrin të përmbushë standardin minimal të një akti administrativ të qartë, të plotë dhe funksional.

Një tjetër problem i vendimit është se ai nuk përcakton pasojat juridike të heqjes dorë. Nuk është e qartë nëse procedura konsiderohet e pezulluar, e transferuar, e ndërprerë, e rikthyer për rishpërndarje apo e lënë në pritje të një vendimi tjetër. Kjo paqartësi e bën të pamundur për palët të kuptojnë pozicionin e tyre procedural dhe të ushtrojnë në mënyrë efektive të drejtat e tyre.

Në një procedurë administrative, qartësia e pasojave juridike është element thelbësor i ligjshmërisë së aktit. Një akt që nuk përcakton qartë pasojat që prodhon, nuk përmbush kërkesat e sigurisë juridike. Palët duhet të dinë se çfarë prodhon vendimi dhe çfarë ndodh pas tij. Vendimi nr. 35 nuk e bën këtë.

Për më tepër, ky vendim bie ndesh edhe me parimin e vazhdimësisë së administratës. Institucioni publik nuk mund të ndalojë funksionimin për shkak të pengesës së një funksionari të veçantë. Administrata duhet të ketë kapacitetin dhe detyrimin të sigurojë vazhdimësinë e procedurave, veçanërisht kur ato lidhen me interes publik. Në rastin konkret, detyrimi për vazhdimësi është edhe më i fortë, sepse çështja është kthyer pranë KQZ-së pas vendimeve të mëparshme të KAS dhe gjykatave.

Mosaktivizimi i një mekanizmi zëvendësues ose institucional krijon rrezikun që çështja të mbetet e pazgjidhur për një kohë të pacaktuar. Kjo është e papranueshme në çdo procedurë administrative, por është edhe më e rëndë në një procedurë që lidhet me mandatin e një funksionari të zgjedhur. Ushtrimi i mandatit publik kërkon qartësi ligjore dhe nuk mund të lihet nën hijen e një procedure të papërfunduar.

Në këtë aspekt, vendimi nr. 35 cenon edhe parimin e përgjegjshmërisë institucionale. Një organ publik duhet të marrë përgjegjësi për çështjet që i janë ngarkuar me ligj. Nëse organi nuk mund të veprojë përmes një funksionari të caktuar, ai duhet të veprojë përmes rrugëve të tjera ligjore. Heqja dorë pa përcaktuar vijimin e procedurës është në thelb shmangie nga përgjegjësia institucionale.

Në rastin konkret, KQZ-ja ka qenë institucioni pranë të cilit çështja është kthyer për shqyrtim. Për këtë arsye, zgjidhja nuk mund të jetë thjesht deklarimi se Komisioneri heq dorë nga shqyrtimi. Zgjidhja duhet të ishte përcaktimi i rrugës institucionale se si KQZ-ja do të përmbushte detyrimin e saj për të shqyrtuar çështjen në themel. Pa këtë element, vendimi mbetet i cunguar dhe i paaftë për të garantuar zbatimin e ligjit.

KAS duhet të vlerësojë se vendimi nr. 35 krijon një boshllëk institucional që nuk mund të lihet në fuqi. Ky boshllëk nuk është çështje teknike, por prek thelbin e së drejtës për vendimmarrje. Nëse nuk përcaktohet organi ose mekanizmi që do të vijojë procedurën, atëherë vendimi prodhon efektin e mohimit të shqyrtimit në themel.

Në këto kushte, është e domosdoshme që KAS të ndërhyjë për të garantuar vijimin e procedurës. KAS duhet të konstatojë se pranimi i heqjes dorë nuk mjafton dhe se vendimi duhet të shoqërohet me përcaktimin e mekanizmit konkret për vazhdimin e shqyrtimit. Çështja duhet t'i kalojë pa vonesë organit ose strukturës kompetente, në mënyrë që të jepet një vendim përfundimtar mbi kushtet e ndalimit për ushtrimin e funksionit publik nga z. Kreshnik Riza Hajdari.

Në përfundim, heqja dorë nga shqyrtimi administrativ, pa përcaktuar vijimin e procedurës, nuk është zgjidhje ligjore. Ajo krijon boshllëk institucional, pasiguri juridike dhe mohim praktik të së drejtës për vendimmarrje. Në një procedurë dekriminalizimi, ku kërkohet reagim i shpejtë dhe efektiv për mbrojtjen e integritetit të funksioneve publike, një vendim i tillë nuk mund të qëndrojë.

Për këto arsye, kërkojmë që KAS të konstatojë se vendimi nr. 35, datë 21.05.2026, është i paplotë dhe joefektiv në pjesën ku nuk përcakton vijimin e procedurës pas heqjes dorë së Komisionerit, dhe të urdhërojë marrjen e masave të menjëhershme për shqyrtimin në themel të çështjes nga organi ose struktura kompetente, brenda një afati të shkurtër dhe të arsyeshëm.

Vendimi nr. 35, datë 21.05.2026, është i cenueshëm në thelbin e tij, pasi nuk përmbush funksionin për të cilin është marrë dhe nuk i jep zgjidhje reale çështjes administrative që lidhet me verifikimin e kushteve të ndalimit për ushtrimin e funksionit publik nga z. Kreshnik Riza Hajdari. Ky vendim, në vend që të orientojë procedurën drejt shqyrtimit në themel dhe dhënies së një vendimmarrjeje përfundimtare, krijon një situatë të paqartë procedurale, ku çështja mbetet pezull, pa organ shqyrtues të përcaktuar, pa afat konkret dhe pa asnjë zgjidhje efektive për objektin kryesor të procedurës.

Në radhë të parë, vendimi është i gabuar për sa i përket përcaktimit të afatit të ankimit. Përcaktimi i afatit 30-ditor nuk i përgjigjet natyrës juridike të aktit, pasi nuk kemi të bëjmë me një vendim përfundimtar mbi themelin e çështjes, por me një vendim procedural dhe të ndërmjetëm, i cili lidhet vetëm me vijimin ose mosvijimin e shqyrtimit nga Komisioneri. Ky vendim nuk zgjidh nëse subjekti vetëdeklarues ndodhet ose jo në kushtet e ndalimit, nuk merr qëndrim mbi mandatin, nuk analizon pasojat e vendimit penal dhe nuk vendos mbi objektin për të cilin çështja është kthyer

pranë KQZ-së. Për këtë arsye, trajtimi i tij si vendim me afat ankimi 30-ditor është i papërshtatshëm dhe krijon një vonesë të pajustificuar në një çështje që, për nga natyra e saj, kërkon shqyrtim të shpejtë dhe efektiv.

Vendosja e një afati të tillë të gjatë për një vendim procedural prodhon pasoja të drejtpërdrejta mbi efektivitetin e procedurës. Në praktikë, ky afat e shtyn edhe më tej zgjidhjen e një çështjeje që ka nisur prej vitit 2023 dhe që ende nuk ka marrë përgjigje përfundimtare mbi themelin. Në një procedurë që lidhet me dekriminalizimin dhe integritetin e një funksionari publik, çdo zvarritje e pajustificuar cenon interesin publik, cenon besimin e qytetarëve te institucionet dhe dobëson qëllimin e ligjit nr. 138/2015. Për këtë arsye, afati 30-ditor nuk mund të konsiderohet si një pasaktësi formale pa pasoja, por si një element që ndikon realisht në zvarritjen e procedurës dhe në pengimin e shqyrtimit në themel.

Vendimi është po ashtu i cenueshëm sepse, ndonëse pranon konfliktin e interesit ose dyshimin objektiv mbi paanësinë e Komisionerit, nuk jep asnjë zgjidhje për vijimin e procedurës. Pranimi i kërkesës për heqje dorë ose për përjashtim nuk mjafton për të përmbushur detyrimin e organit administrativ. Nëse Komisioneri ka qenë në kushtet e mungesës së paanësisë objektive, ai nuk mund ta linte çështjen pa drejtim procedural. Detyrimi i tij institucional ishte të garantonte që çështja t'i kalonte menjëherë një organi, strukture ose mekanizmi tjetër kompetent, në mënyrë që shqyrtimi të vijonte dhe të përfundonte me vendim mbi themelin.

Konflikti i interesit nuk mund të kthehet në arsye për mosveprim. Ai është një garanci për një proces të paanshëm, por nuk mund të përdoret si shkak për bllokimin e procedurës. Në rastin konkret, vendimi nr. 35 krijon pikërisht këtë pasojë: nga njëra anë pranon se Komisioneri nuk duhet të vijojë shqyrtimin, ndërsa nga ana tjetër nuk përcakton se kush do ta vijojë atë. Kjo krijon boshllëk institucional dhe e lë çështjen në një gjendje pasigurie, ku nuk dihet se cili organ do të vendosë, kur do të vendosë dhe sipas cilës procedurë do të vijojë shqyrtimi.

Ky boshllëk është në kundërshtim me parimin e administrimit të mirë dhe me detyrimin e organeve publike për të vepruar brenda kompetencës së tyre. Një organ administrativ nuk mund të konstatojë një pengesë procedurale dhe të ndalet aty. Ai duhet të marrë masat e nevojshme për kapërcimin e saj, në mënyrë që e drejta e palëve për një vendimmarrje efektive të mos mbetet vetëm formale. Në rastin konkret, pala ankuese ka kërkuar shqyrtim të paanshëm, jo lënien e çështjes pa shqyrtim. Për këtë arsye, pranimi i kërkesës për përjashtim duhej të shoqërohej domosdoshmërisht me përcaktimin e rrugës së vijimit të procedurës.

Vendimi nr. 35 është i cenueshëm edhe sepse nuk zbaton realisht vendimin e KAS, vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimin e Gjykatës së Lartë. Këto vendimmarrje kanë orientuar qartë që çështja të vijojë të shqyrtohet pranë KQZ-së dhe të marrë zgjidhje në rrugë administrative. Ky detyrim nuk mund të përmbushet përmes një vendimi që vetëm konstaton heqjen dorë të Komisionerit dhe nuk vendos asgjë mbi vijimin e procedurës. Zbatimi i vendimeve të mëparshme kërkonte shqyrtim real, analizë të plotë dhe vendimmarrje mbi themelin, jo thjesht një akt procedural që e lë çështjen në pritje.

Në këtë kuptim, vendimi nr. 35 nuk përbën zbatim të vendimeve të KAS dhe gjykatave, por shmangie nga efekti i tyre. Kur KAS e ka kthyer çështjen për rishqyrtim dhe kur gjykatat kanë

konfirmuar se shqyrtimi duhet të vijojë pranë KQZ-së, organi administrativ nuk mund ta konsiderojë të përmbushur detyrimin e tij vetëm duke zhvilluar një seancë dhe duke deklaruar heqjen dorë. Rishqyrtimi nënkupton hyrje në analizën e çështjes, vlerësim të akteve, të provave, të vendimit penal, të pasojave ligjore dhe të kushteve të ndalimit. Asnjë nga këto elemente nuk është trajtuar në mënyrë efektive në vendimin objekt ankimi.

Për më tepër, vendimi shmang shqyrtimin në themel të çështjes së dekriminalizimit. Ai nuk merr asnjë qëndrim mbi faktin nëse z. Kreshnik Riza Hajdari ndodhet ose jo në kushtet e ndalimit për ushtrimin e funksionit publik. Nuk analizohet ndikimi i vendimit penal nr. 6, datë 25.01.2024, të Gjykatës së Posaçme, nuk analizohet vepra penale për të cilën subjekti është deklaruar fajtor, nuk analizohet momenti kohor i procedimit dhe i dënimit, nuk analizohet ndikimi i këtyre rrethanave mbi formularin e vetëdeklarimit dhe as pasojat që ato mund të kenë mbi ligjshmërinë e ushtrimit të mandatit.

Kjo mungesë analize është thelbësore, pasi objekti kryesor i procedurës nuk ishte paanësia e Komisionerit në vetvete, por verifikimi i kushteve të ndalimit sipas ligjit nr. 138/2015. Çështja e paanësisë ishte vetëm një incident procedural i lindur gjatë procedurës. Duke u marrë vetëm me këtë incident dhe duke mos përcaktuar vijimin e shqyrtimit në themel, vendimi ka zhvendosur vëmendjen nga objekti kryesor dhe ka lënë pa përgjigje çështjen që kishte rëndësi reale për palët dhe për interesin publik.

Në këto kushte, vendimi nr. 35 nuk është thjesht i paplotë, por është joefektiv. Ai nuk prodhon zgjidhje, nuk i jep përgjigje pretendimeve të palës ankuese, nuk zbaton vendimet detyruese të mëparshme, nuk garanton vijimin e procedurës dhe nuk siguron një vendimmarrje mbi themelin e çështjes. Një vendim i tillë cenon parimin e sigurisë juridike, sepse palët mbeten në pasiguri mbi fatin e procedurës dhe mbi organin që do të vendosë. Cenon parimin e afatit të arsyeshëm, sepse krijon vonesa të reja në një çështje tashmë të zvarritur. Cenon parimin e efektivitetit, sepse nuk jep asnjë zgjidhje reale. Cenon edhe interesin publik, sepse çështja lidhet me ushtrimin e një funksioni publik dhe me integritetin e një subjekti të zgjedhur.

Përfundimisht, vendimi nr. 35, datë 21.05.2026, nuk mund të qëndrojë në formën e tij aktuale. Ai duhet të ndryshohet ose të shfuqizohet, pasi nuk i përgjigjet natyrës së procedurës, nuk garanton vijimin e shqyrtimit, nuk zbaton vendimet e mëparshme dhe nuk vendos mbi themelin e çështjes së dekriminalizimit. KAS duhet të konstatojë se çështja nuk mund të mbetet pa zgjidhje për shkak të konfliktit të interesit të Komisionerit dhe duhet të urdhërojë vijimin e menjëhershëm të procedurës nga organi ose struktura kompetente, me qëllim dhënien e një vendimi përfundimtar mbi kushtet e ndalimit për ushtrimin e funksionit publik nga z. Kreshnik Riza Hajdari.

Për këto arsye,

#### **KËRKOJMË:**

1. Pranimin e ankimit.
2. Ndryshimin ose shfuqizimin e vendimit nr. 35, datë 21.05.2026, për pjesën ku Komisioneri kufizohet vetëm me "heqjen dorë" nga shqyrtimi administrativ, pa përcaktuar mekanizmin e vijimit të procedurës.



3. Detyrimin e KQZ-së/organit kompetent që të vijojë menjëherë shqyrtimin administrativ në themel të çështjes dhe të marrë vendim përfundimtar mbi verifikimin e kushteve të ndalimit për ushtrimin e funksionit publik nga z. Kreshnik Riza Hajdari.

ANKUES

Lefter Maliqi Partia e Lirisë

PËRFAQËSUES

Av. Arben Llangozi

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Arben Llangozi', is written over the printed name of the representative.

SHPEKINDA  
AL  
30 MAY 1965